

Plagosja e mbrëmshme në Prishtinë – arrestohen e më pas lirohen dy persona, dy të tjerë në arrati

LAJME



12/01/2024 08:45



Një person ka mbetur mbrëmë i plagosur nga arma e zjarrit në rrugën “Bajram Bahtiri” në Prishtinë. I njëjti ka marrë trajtim në QKUK.

Për rastin për të cilin raportoi lajmi.net, policia thotë se ishin të përfshirë katër persona.

Organet e rendit kanë arritur të prangosin dy të dyshuar lidhur me rastin, por të cilët janë liruar në procedurë të rregullt.

Dy të tjerët e dyshuar, sipas njoftimit, vazhdojnë të mbesin në arrati.

“Raportohet se ka pasur të shtëna me armë zjarri në mes katër të dyshuarve meshkuj kosovarë. Si pasojë, një i dyshuari është plagosur dhe është trajtuar në QKUK. Dy të dyshuar janë arrestuar dhe me vendim të prokurorit janë liruar në procedurë të rregullt, ndërsa dy të dyshuarit tjerë gjenden në arrati”, thuhet në njoftim.

Më shumë nga uebi

nativeGRAM
by LupanMedia



Pronarja nuk pranon ta shesë qenin e saj as për 200 mijë



Aeroplani i nisur nga Prishtina për në Gjenevë kthehet në



“Ti je gjithmonë fituesi im”, lajmërohet me në fund



Haradinaj: VV-ja e sheh Thaçin si ‘lugat’




Mavijoseni lehtë? Mund të jetë një shenjë e diçka më

Artikuj të ngjashëm




January 12, 2024

Mehaj: Blerja e raketave anti-tank “Javelin” ka nisur në mandatin tonë



January 12, 2024

Vuanin nga probleme psikike, zhduket një person nga Istogu e tjetri...



January 12, 2024

Rrahje në një restaurant në Suharekë, pesë të arrestuar e tre të lënduar



January 12, 2024

Burri italian ther me thikë gruan gjermane në Fushë Kosovë, arrestohet



January 12, 2024

Arrestohet një person në Kaçanik, publikoi video duke shtënë me armë



January 12, 2024

Bajqinovci: Mendoj që më së miri Asociacioni duhet të dizajnohet nga...